



Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr. 06-9271 2026

Datë: 01.04 2026

Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 40 paragrafi 40.2 shkronjën c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.3/L-040, Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Nenit 6, 8 dhe nenit 9 të Ligjit 10/L-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026. Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal. Nenit 40, piken 3 të Statutit të Komunës së Klinës, me kërkesën e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim të datës: 17.03.2026 me nr. prot. 0nr.401-8502/26, si dhe me Rekomandimet e Komitetit për Politik dhe Financa të datës 18.03.2026, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e III-të të rregullt për vitin 2026 të mbajtur më datën: 27.03.2026, mori këtë :

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për rritjen e buxhetit nga tejkalimi i planit të të hyrave vetanake për vitin 2025, bartjen e mjeteve të pa shpenzuara nga viti 2025 në vitin 2026 dhe shpërndarjen e tyre. Shuma e përgjithshme **825,142.11 Euro**.
2. Nga shuma e përgjithshme **825,142.11 €** nga fondi 21 dhe 22 është shuma prej **268,444.31 €** dhe nga tejkalimi i planifikimit të të hyrave shuma prej **556,697.80 €**. Sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave Ligjit të buxhetit për vitin 2026 dhe Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nga teprica e mjeteve nga viti paraprak që barten në vitin vijues paguhen obligimet nga viti paraprak sipas kontratave të nënshkruara.
3. Shuma e mjeteve financiare si në nenin 2 të këtij vendimi shpërndahet në programe dhe nen-programe buxhetore dhe në kategori ekonomike të shpenzimeve si në vijim:
 - 3.1. Mallra dhe Shërbime në shumën prej **310,300.70 €**;
 - 3.2. Shpenzimet komunale në shumën prej **120,000.00 €**;
 - 3.3. Subvencione dhe transfere shumën prej **26,244.65 €**.
 - 3.4. Shpenzime kapitale në shumën prej **368,596.76 €**;
4. Mjetet buxhetore në shumë prej **310,300.70 €** si në nenin 3 paragrafi 3.1 të këtij vendimi barten dhe shpërndahen si në vijim:

Në kategorinë mallra dhe shërbime :

- Programi Arsim dhe Shkencë (920), nënprogrami Arsimit Parafillor (92550), kodi funksional (0911), shuma prej **8,231.55 €**;
- Programi Arsim dhe Shkencë (920), nënprogrami Arsimit Mesëm (94710), kodi funksional (0922), shuma prej **12,363.40 €**;
- Programi Arsim dhe Shkencë (920), nënprogrami Administrata (92090), kodi funksional (0980), shuma prej **49,705.75 €**;

- Programi Shëndetësia dhe mirëqenia sociale (730), nënprogrami Shërbimet e shëndetësisë primare (74050), kodi funksional (0721), shuma prej **40,000.00 €**;
- Programi Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia (180), nënprogrami Infrastruktura Rrugore (18018), kodi funksional (0451), shuma prej **100,000.00 €**;
- Programi Buxhet dhe Financa (175), nënprogrami Buxhetimi (17518), kodi funksional (0112), shuma prej **100,000.00 €**;

5. Mjetet buxhetore në shumë prej **120,000.00 €** si në nenin 3 paragrafi 3.2 të këtij vendimi barten dhe shpërndahen si në vijim:

Në kategorinë e shpenzimeve komunale :

- Programi Buxhet dhe Financa (175), nënprogrami Buxhetimi (17518), kodi funksional (0112), shuma prej **120,000.00 €**;

6. Mjetet buxhetore në shumë prej **26,244.65 €** si në nenin 3 paragrafi 3.3 të këtij vendimi barten dhe shpërndahen si në vijim:

Në kategorinë e subvencioneve dhe transferove

- Programi Zyra e Kryetarit (160), nënprogrami Zyra e Kryetarit (16018), kodi funksional (0111), shuma prej **13,285.65**;
- Programi Arsimit dhe Shkencë (920), nënprogrami Administrata (92090), kodi funksional (0980), shuma prej **12,959.00 €**;

7. Mjetet buxhetore në shumë prej **368,596.76 €** si në nenin 3 paragrafi 3.4 të këtij vendimi barten dhe shpërndahen si në vijim:

Në kategorinë e shpenzimeve kapitale:

- Programi Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660) nënprogrami Planifikimi urban dhe inspeksioni (66395), kodi funksional (0620), në projektin “Bashkëfinancim me donatorë”, kodi i projektit 48267, në shumën prej **45,000.00 €**;
- Programi Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660) nënprogrami Planifikimi urban dhe inspeksioni (66395), kodi funksional (0620), në projektin “Ndertimi i kanalizimit ne Shtupel-Kernice-Binxhe-Grabce”, kodi i projektit 54297, në shumën prej **25,000.00 €**;
- Programi Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660) nënprogrami Planifikimi urban dhe inspeksioni (66395), kodi funksional (0620), në projektin “Ndertimi i infrastruktures nentoksore dhe mbitoksore ne Poterq-Dugajev-Drenovc”, kodi i projektit 54344, në shumën prej **39,910.34 €**;
- Programi Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660) nënprogrami Planifikimi urban dhe inspeksioni (66395), kodi funksional (0620), në projektin “Rindërtimi i rrugëve te Qytetit te Klines me segmente te tyre: S.Rexhepi, M.Daka, M.Haxhaj, L.Palucaj, H.Prishtina, I.Qemajli, F.Bojaj, B.Mustafa, Sh.Sadiku, HKrasniqi, Vellezerit Gervall”, kodi i projektit 56057, në shumën prej **24,152.16 €**;
- Programi Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660) nënprogrami Planifikimi urban dhe inspeksioni (66395), kodi funksional (0620), në projektin “Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukturës nëntokësore Zllakuqan-Pataqan-Berkove, Krushevë e Vogël (trotuari Klinë-Zllakuqan)”, kodi i projektit 56078, në shumën prej **5,000.00 €**;
- Programi Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660) nënprogrami Planifikimi urban dhe inspeksioni (66395), kodi funksional (0620), në projektin “Ndertimi i infrastrukturës mbitokesore dhe infrastrukturës nentokesore Volljake-Sferke-Qupeve-Dush”, kodi i projektit 56084, në shumën prej **5,000.00 €**;

- Programi Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660) nënprogrami Planifikimi urban dhe inspeksioni (66395), kodi funksional (0620), në projektin “Ndertimi i infrastruktures mbitokesore dhe infrastruktures nentokesore Gjurgjevik i madh-Dush”, kodi i projektit 56094, në shumën prej **13,606.86 €**;
- Programi Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia (180), nënprogrami Infrastruktura Rrugore (18018), kodi funksional (0451), në projektin “Rindertimi i infrastruktures mbitokesore me asfalt ne Jashanice,Shtupel,Zllakuqan,Kline-Videje etj”, kodi i projektit 56126, në shumën prej **100,000.00 €**;
- Programi Arsim dhe Shkencë (920), nënprogrami Administrata (92090), kodi funksional (0980), në projektin “Ndertimi i nxemjeve qendrore me pompa termike dhe nxemje me kaldaja me pelet ne shkolla në Gjimnazin Luigj Gurakuqi, Gremnik, Këpuz, Zllakuqan, Gjurgjevik I Madh, Budisalc, Ujmire, Dren”, kodi i projektit 56137, në shumën prej **27,824.52 €**;
- Programi Arsim dhe Shkencë (920), nënprogrami Administrata (92090), kodi funksional (0980), në projektin “Ndërtimi I fushave sportive dhe parkingjeve në shkolla në Grabanicë, Siqevë, Zllakuqan, Leskoc, Sferkë etj”, kodi i projektit 56147, në shumën prej **20,000.00 €**;
- Programi Shëndetësia dhe mirëqenia sociale (730), nënprogrami Shërbimet e shëndetësisë primare (74050), kodi funksional 0721, në projektin “Ndertimi dhe rindertimi I objekteve shendetesore: QKMF, AMF Drenoc, Ujmire, Zllakuqan dhe Gllareve etj”, kodi i projektit 56149, në shumën prej **10,150.00 €**;
- Programi Shërbimet Sociale dhe Rezidenciale (755), nënprogrami Shërbimet Rezidenciale (75587), kodi funksional (1060), në projektin “Ndërtimi i shtëpisë se pleqeve ne Kline”, kodi i projektit 54463, në shumën prej **6,991.00 €**;
- Programi Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi (470), nënprogrami Bujqësia (47018), kodi funksional(0421), në projektin “Ndërtimi i kanaleve te ujitjes në Rudicë-Stupë-Videjë-Zajm,Potërq-Dollovë, Volljakë-Këpuz etj”, kodi i projektit 56152, në shumën prej **45,961.88 €**;

Arsyetim:

Vendimi për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 dhe vitet paraprake në vitin 2026, duke përfshirë edhe tejkalimin e planit të të hyrave vetanake, konfirmojmë se nuk ka ndryshime në strukturën e shpenzimeve.

Bartja e të hyrave në kategorinë e shpenzimeve për mallra dhe shërbime, në shumën prej **310,300.70 €**, bëhet për mbulimin e obligimeve të kontraktuara në vitin 2025, si dhe për shpenzimet për pastrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave, pastrimin e rrugëve, pastrimin e ndërtesave administrative, shëndetësore dhe arsimore, etj.

Bartja e të hyrave në kategorinë e shpenzimeve komunale, në shumën prej **120,000.00 €**, bëhet për mbulimin e obligimeve të bartura si borxh nga viti 2025, si dhe për shpenzimet e rritura për zgjerimin e rrjetit të ndriçimit dhe për shpenzimet e nxemjeve qendrore me pompa termike, etj.

Bartja e të hyrave në kategorinë e shpenzimeve për subvencione dhe transfere, në shumën prej **26,244.65 €**, bëhet për mbulimin e shpenzimeve të varrimit, për ndihmë financiare për studentët, përkrahje të kulturës, zhvillimit ekonomik dhe bujqësisë.

Bartja e të hyrave në kategorinë e shpenzimeve kapitale, në shumën prej **368,596.76 €**, bëhet për mbulimin e obligimeve të kontraktuara gjatë vitit 2025 dhe viteve paraprake, për vazhdimin e projekteve të papërfunduara, etj. Këto shpenzime janë të domosdoshme për realizimin e investimeve të rëndësishme infrastrukturore dhe zhvillimore që ndihmojnë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe zhvillimin ekonomik të komunitetit.

8. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.
9. Vendimi hynë në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës, bazuar në Ligjin Nr.08/L-284, si dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- *MAPL;*
- *Kryetari i Komunës;*
- *Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;*
- *Zyra për Informim;*
- *Arkivi.*



Kryesues i Kuvendit
Enver Berisha